



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 115 Datë 22.07.2019

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 265, DATË 20.12.2018, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BE – IS ENERGY” SH.P.K, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET: “KALIVAR 1” ME FUQI TË INSTALUAR 1475 KW; HIDROCENTRALI “KALIVARË 2” ME FUQI TË INSTALUAR 526 KW; HIDROCENTRALI “KALIVARË 3” ME FUQI TË INSTALUAR 3321 KW; DHE HIDROCENTRALI “KALIVARË 4” ME FUQI TË INSTALUAR 275 KW, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 5597 KW.

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 113, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.07.2019 mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për një ndryshim në Vendimin e bordit të ERE-s nr. 265, datë 20.12.2018, për licencimin e shoqërisë “BE – IS ENERGY” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Kalivar 1” me fuqi të instaluar 1475 kW; Hidrocentrali “Kalivarë 2” me fuqi të instaluar 526 kW; Hidrocentrali “Kalivarë 3” me fuqi të instaluar 3321 kW; dhe Hidrocentrali “Kalivarë 4” me fuqi të instaluar 275 kW, me Fuqi Totale të instaluar 5597 kW,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 265, datë 20.12.2018, ka vendosur:
 1. Të licencojë shoqërinë “BE-IS Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Kalivar 1” me fuqi të instaluar 1475 kW; Hidrocentrali “Kalivarë 2” me fuqi të instaluar 526 kW; Hidrocentrali “Kalivarë 3” me fuqi të instaluar 3321 kW; dhe Hidrocentrali “Kalivarë 4” me fuqi të instaluar 275 kW, me Fuqi Totale të instaluar 5597 kW, për një afat 30 vjeçar, me kusht që brenda 6 muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi të depozitohë në ERE kontratën shtesë të koncesionit që do të nënshkruajë me MIE, në zbatim të nenit 28,

- të Kontratës së Koncesionit me nr. 1659 Rep dhe nr. 561/1 Kol, datë 04.07.2016, për ndryshimin e parametrave teknike të HEC-eve Kalivare 1, Kalivare 2, Kalivare 3 dhe Kalivare 4.*
2. *Subjekti “BE-IS Energy” sh.p.k. në përfundim të afatit 5 vjeçar të Lejes së Përdorimit të Ujit, të paraqesë në ERE Lejen e rinovuar për periudhën në vazhdim.*
 3. *Subjekti “BE –IS Energy” sh.p.k në përfundim të afatit të Kontratës së Qirasë nr. 2417 Prot., datë 30.12.2017, të lidhur ndërmjet saj dhe Bashkisë Pukë, “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullësor për ndërtimin e Hec-ve “Kalivare” 1,2,3,4 nga shoqëria “BE-IS” sh.p.k. ”, të paraqesë në ERE kontratën e rinovuar në zbatim të legjislacionit në fuqi.*
- ERE me shkresën “Kujtesë” nr. 382 Prot., datë 31.05.2019, i’u drejtua shoqërisë “BE – IS Energy” sh.p.k,me kërkesën për informacion në lidhje me plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 1 të dispozitivit të vendimit nr. 265, datë 20.12.2018.
 - Sa i përket kushtit të parë të vendosur në dispozitivin e Vendimit nr. 265, datë 20.12.2018, shoqëria ka bërë me dije më herët se : MIE me shkresën nr. 3286/10 Prot., datë 30.10.2018, ka bërë me dije se: *Procedurat për nënshkrimin e kontratës shtesë mes dy palëve, do të kryhet në të njëjtën kohë me paraqitjen e ndryshimit të parametrave hidroenergjitikë në përputhje me projektin e zbatimit si dhe zgjatja e afatit të ndërtimit të veprës. Zgjatja e afatit bëhet në funksion të marrjes së lejes së ndërtimit, nga data kur merret kjo leje.*
 - Shoqëria “BE-IS Energy” sh.p.k me shkresën nr. 115 Prot., datë 06.06.2019, protokolluar në ERE me nr. 382/1 Prot., datë 07.06.2019, bën me dije si më poshtë:

Ka kryer aplikimin pranë Këshillit kombëtar të Territorit, i cili siç rezulton nga aplikimi bashkëlidhur kësaj korrespondence, është në fazën e shqyrtimit të këtij aplikimi.
Plotësimi i kushtit sa më sipër, hap rrugën për aplikimin në MIE dhe nënshkrimin e kontratës shtesë të koncesionit.
 - Oponenca Teknike, është realizuar nga AKBN, referuar shkresave nr. 1158/3 Prot, datë 11.05.2017, drejtuar MIE, për projektin e zbatimit të hidrocentraleve “Kalivar 1” me fuqi të instaluar 1475 kW; Hidrocentrali “Kalivar 2” me fuqi të instaluar 526 kW; Hidrocentrali “Kalivar 3” me fuqi të instaluar 3321 kW; dhe Hidrocentrali “Kalivar 4” me fuqi të instaluar 275 kW, me Fuqi Totale të instaluar 5597 kW.
 - AKBN shprehet se projekti i zbatimit për HEC-et “Kalivare”, plotëson kushtet dhe standartet e projektimit. Zgjidhjet teknike të veprave hidroenergjitike si dhe komponimi i tyre në nyjet hidroenergjitike është dhënë drejt dhe argumentuar nga pikëpamja tekniko – mjedisore.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka miratuar këtë projekt zbatimi me shkresën nr. 132/49, datë 25.07.2017.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit të bordit të ERE nr. nr. 265 datë 20.12.2018, si më poshtë:

Të licencojë shoqërinë “BE-IS Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Kalivar 1” me fuqi të instaluar 1475 kW; Hidrocentrali “Kalivar 2” me fuqi të instaluar 526 kW; Hidrocentrali “Kalivar 3” me fuqi të instaluar 3321 kW; dhe Hidrocentrali “Kalivar 4” me fuqi të instaluar 275 kW, me Fuqi Totale të instaluar 5597 kW, për një afat 30 vjeçar, **me kusht që nëse para vënies në operim të veprës nuk depoziton në ERE kontratën shtesë të koncesionit që do të lidhë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të ushtrojë aktivitetin mbështetur në Kontratën e Koncesionit me nr. 1659 Rep dhe nr. 561/1 Kol, datë 04.07.2016.**

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI